# RAPORT VJETOR

# I KOLEGJIT UNIVERSITAR "LUARASI"

## *VITI AKADEMIK 2017 - 2018*

***Tiranë, Shtator 2018***

Rruga e Elbasanit, Nd. 59, H. 1, Kodi Postar 1010 Tiranë
www.luarasi-univ.edu.al; Tel: 0696026900; Email: info@luarasi.univ.edu.al

# PASQYRA E LËNDËS

HYRJE ..... **4**

**PJESA E PARË**

"ASPEKTE TË MENAXHIMIT AKADEMIK"

I. HISTORIK I SHKURTËR I KOLEGJIT UNIVERSITAR "LUARASI" ..... **5**

II. REALIZIMI VJETOR I QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË INSTITUCIONIT ..... **7**

1. Struktura organizative dhe titullarët ..... 9

III. INFORMACION MBI TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT QË OFRON KU "LUARASI" **11**

1. Përshtatshmëria e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimi i synmeve të programeve dhe lidhjen e programeve me kerkesat e tregut të punës ..... **12**

2. Realizimi i synimeve të programeve të studimit nga ana përmbajtësore ..... **13**

3. Realizimi i synimeve të programit të studimit nëpërmjet mbulimit me personelin akademik të përshtatshëm ..... **14**

4. Informacion mbi marrjen e lejës për hapjen e programeve të studimit që janë në process vlerësimi ..... **14**

IV. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME NUMERIKE TË INSTITUCIONIT ..... **15**

1. Të dhënat statistikore mbi studentët ..... **15**

2. Të dhënat mbi personeli akademik ..... **23**

V. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE PROJEKTET KU MERR PJESË KU "LUARASI" ..... **32**

VI. INFORMACION MBI KËRKIMIN SHKENCOR NË KU "LUARASI" ..... **34**

1. Konferenca Shkencore Ndërkombëtare ..... **35**

2. Leksione të hapura ..... **36**

3. Aktiviteti individual kërkimor shkencor i personelit akademik të Kolegjit Universitar "Luarasi" për vitin akademik 2017 – 2018 ..... **39**

4. Botime të KU "Luarasi" ..... **44**

5. Veprimtari mediatike ..... **44**

VII. KËSHILLI STUDENTOR DHE PËRFAQËSIMI I STUDENTËVE NË ORGANET DREJTUESE TË KU "LUARASI" ..... **45**

VIII. VLERËSIME TË INSTITUCIONIT MBI MASR DHE REKOMANDIME ..... **47**

PJESA E DYTË

"ASPEKTE TË MENAXHIMIT ADMINISTRATIV"

# HYRJE

Raporti Vjetor të Veprimtarisë Mësimore – Kërkimore për vitin akademik 2017 – 2018 është hartuar bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin Nr. 5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementëve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë" dhe Satutin të Kolegjit Universitar "Luarasi". Raporti është i ndarë në dy pjesë.

Pjesa e parë e Raportit e titulluar "Aspekte të menaxhimit akademik", është hartuar nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar "Luarasi" si organi kolegjial më i lartë akademik i institucionit, përgjegjës për përmbushjen e misionit të KU "Luarasi." dhe në zbatim të funksioneve të tij të parashikuara në legjislacioni në fuqi.

Pjesa e dytë e Raportit e titulluar "Aspekte të menaxhimit administrativ", është hartuar nga Bordi i Administrimit i Kolegjit Universitar "Luarasi" si organi më i lartë kolegjial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të KU "Luarasi", mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij dhe në zbatim të funksioneve të tij të parashikuara në legjislacioni në fuqi.

Raporti Vjetor 2017-2018 është miratuar në mbledhjen e përbashkët të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të Kolegjit Universitar "Luarasi" me Vendimin Nr. 1, datë 28.09.2018.

## PJESA E PARË "ASPEKTE TË MENAXHIMIT AKADEMIK"

### I. HISTORIK I SHKURTËR I KOLEGJIT UNIVERSITAR "LUARASI"

Kolegji Univeristar "Luarasi" (KU "Luarasi") (më parë Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Luarasi" (SHLUJ "Luarasi") është një institucion jopublik i arsimit të lartë në Shqipëri. KU "Luarasi" është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.611, datë:11.09.2003 "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Luarasi." Mbi bazën e këtij akti, institucioni ka nisur veprimtarinë e mësimdhënies, në vitin akademik 2003–2004 fillimisht me Fakultetin e Drejtësisë. Veprimtaria e institucionit është normuar, kronologjikisht, nga aktet nënligjore në vijim:

i. Me **Urdhër Nr. 483, datë 12.10.2012**, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për hapjen e disa programeve të reja të studimit të Ciklit të parë dhe të Ciklit të dytë pranë SHLUJ "Luarasi", u realizua:

   a) Hapja e programeve të studimit të Ciklit të parë "Bachelor" në: "Ekonomiks", "Administrim Biznes" dhe "Financë Bankë", me kohë të plotë, me 180 kredite, dhe kohëzgjatje 3 vite akademike.
   b) Hapja e programeve të studimit të Ciklit të dytë "Master Profesional" në "E Drejtë Bankare dhe Financiare" dhe 'Kontabilitet", me kohë të plotë, me 90 kredite, dhe kohëzgjatje 1.5 vite akademike.
   c) Hapja e programeve të studimit të Ciklit të dytë "Master i shkencave" në "Menaxhim Ekzekutiv" dhe "Bankat dhe Tregjet Financiare", me kohë të plotë, me 120 kredite, dhe kohëzgjatje 2 vite akademike.

ii. **Me Urdhër Nr. 188, datë 15.05.2015**, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për riorganizimin e njësive kryesore të institucionit të arsimit të lartë "Shkolla e Lartë Universitare Private "Luarasi"", institucioni është riorganizuar në dy njësi kryesore:

   **a) Fakulteti Ekonomik**
   **b) Fakulteti i Drejtësisë**

Prej vitit 2012, institucioni, konform strategjisë së zhvillimit institucional, misionit dhe qëllimit, ka zgjeruar aktivitetin, duke ofruar disa programe të reja studimi në fushën e drejtësisë si edhe programe studimi në fushën ekonomike, në kuadër të Fakultetit Ekonomik.

Me **Urdhër Nr. 266, datë 14.05.2018** të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë u miratua hapja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit. Me këtë Fakultet të ri dhe programet që ai do të ofrojë, rritet oferta akademike e KU "Luarasit" dhe i përgjigjemi më mirë kërkesave të tregut të punës.

Vlen te theksohet se të gjitha Diplomat e shpërndara deri tani bazohen në programet e studimit që janë aktualisht të akredituara. Gjatë vitit akademik 2017-2018 KU "Luarasi" ofroi studime, me kohë të plotë, në dy degë: Drejtësi dhe Ekonomi, në dy Cikle studimi: "Bachelor" dhe "Master" i Shkencave dhe Master Profesional.

Programet e studimit që aktualisht ofron KU "Luarasi" lidhen ngushtësisht me nevojat e tregut të punës dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik të vendit. Të diplomuarit në këto degë janë një kontigjent i kualifikuar për të kontribuar në dy shtylla të fuqishme të zhvillimit dhe demokratizimit të vendit: në sistemin e drejtësisë dhe në fushën ekonomike.

Ndryshimet në strukturën organizative të KU "Luarasi", pas akreditimit të parë institucional (2008), reflektojnë si përshtatjen me ndryshimet që kanë ndodhur në legjislacionin kombëtar, në fushën e arsimit të lartë, përgjatë këtyre viteve, ashtu edhe zgjerimin e aktivitetit të institucionit me njësi përbërëse organizative dhe programe të reja studimi.

Struktura aktuale organizative gjen pasqyrimin e saj ne Statutin e KU " Luarasit". Ajo është konceptuar bazuar në përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe aktet normative të institucionit – Statut dhe Rregullore e Brendshme. Me miratimin e Statutit të ri nga Ministri i MAS-it, me Urdhërin Nr.515, datë 27.10.2016, SHLJU "Luarasi" Bazuar në Nenin 20 të ligjit të mësipërm emërtohet Kolegji Universitar "Luarasi" (KU "Luarasi").

Statuti dhe Rregullorja e e Brendshme e institucionit përcaktojnë në mënyrë të detajuar përbërjen, kompetencat e secilit organ/autoritet dhe mënyrën e funksionimit të secilit prej Organeve Drejtuese, Autoriteteve Drejtuese të KU "Luarasi", njësitë bazë si dhe njësitë ndihmëse/administrative të saj.

Fushat në të cilat u krye Akreditimi institucional i KU " Luarasit" nga ekspertet e jashtëm të ASCAL-it dhe Agjencisë Britanike ishin:

1. Organizimi dhe Manaxhimi
2. Burimet
3. Kurrikula
4. Mësimdhënia , Mësimnxënia , vlerësimi dhe kërkimi shkencor
5. Studentët dhe mbështetja e tyre

Në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm nga grupi i ekspertëve (I përbërë nga dy anglezë dhe një shqiptar) KU "Luarasi" mori vlerësimin maksimal për të pesë fushat e mësipërme. Ekipi nuk konstatoi asnjë dobësi dhe nuk dha asnjë rekomandim duke dhene një gjykim përdfundimatar se standardet dhe kriteret për arsimin e lartë në Republiken e Shqipërisë janë përmbushur plotësisht nga KU "Luarasi".

Bordi i Akreditimit, bazuar në këtë raport dhe gjykim, me vendimin Nr. 115, datë 15.12.2017 konfirmoi se akreditimi institucional për KU "Luarasin" është i vlefshëm deri më 14.12.2023 pra, për një periudhë maksimale 6 vjeçare.Kjo është një arritje e merituar dhe është frut i punës të të gjithë aktorëve të përfshirë në KU "Luarasi": Studentët, pedagogët, stafi ndihmës, si dhe i përkrahjes dhe mbështetjes së vazhdueshme të pronarëve të "Hysenbelliu Grup". Ky vlerësim maksimal pozitiv

na inkurajon dhe nxit për të realizyuar akoma më mirë Misionin dhe Vizionin e KU "Luaras-it" në arritjen e objektivave stradegjike afatgjata dhe objektivave afatshkurtra.

## II. REALIZIMI VJETOR I QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË INSTITUCIONIT

Duke e konsideruar veten si një institucion serioz në tregun ë arsimit  të lartë privat në Shqipëri, KU "Luarasi" synon të shërbej si një qendër e specializuar në fushën e studimeve juridike dhe ekonomike në vend, me ndikim në rajon e më gjerë; si dhe një qendër për kërkimin shkencor në drejtimet specifike ku KUL-i zotëron potencialin e nevojshëm njerëzor dhe financiar.

Misioni i KU "Luarasi", është në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i shprehur në nenin 1 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me standardet ndërkombëtare si dhe në veçanti  me synimin e këtij institucioni për krijimin e një qëndre ekselence të edukimit dhe kërkimit shkencor.

Vizioni i KU "Luarasi" përmblidhet në angazhimin për krijimin e një institucioni elitar, që prodhon elita profesionistësh, duke qenë lider në zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare. Studentëve u ofrohet një edukim cilësor, që reflekton rezultatet e kërkimit shkencor të vazhdueshëm dhe përpjekjet për  shfrytëzimin e arritjeve më të mira të shkencës, në fushat përkatëse të studimit.

KU "Luarasi", përgjatë vitit 2017-2018, ka krijuar dhe konsoliduar reputacionin dhe rritur standartet cilësore në mësimdhenie dhe kërkimin shkencor në fushën e Drejtësisë dhe të Ekonomisë. Programet mësimore në Ciklin e parë të studimevë "Bachelor" dhe në Ciklin e dytë të studimeve "Master Profesional"  dhe " Master i shkencave" që ofrohen nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti Ekonomik, janë bashkëkohore dhe përputhen me kërkesat që ka sot tregu i punës.

Arritjet e deritanishme janë rezultat i dinamikës dhe strategjisë së  zhvillimi  e cila mbështet  mbi filozofinë e përgatitjes së specialistëve të rinj profesionistë në fushën e drejtësisë dhe ekonomisë me njohuri,  aftësi dhe kompetenca bashkekohore. Objektiv apo synimi i përhershëm i çdo programi mësimor ka qënë dhe mbetet formimi i specialistëve të rinj profesionistë konkurrues të denjë në tregun e punës  dhe që t'i përshtaten kërkesave reale  të tregut të punës.

Strategjia e KU "Luarasi" është në pajtueshmëri me prirjet kryesore të zhvillimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri, tendecat e zhvillimit te arsimit të lartë në Europë dhe në botë, dhe në veçanti, me procesin e Bolonjës. Qëllimi i aritjeve të objektivave stradegjike është të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies nga stafi akademik, të rrisë nivelin e dijeve, njohurive dhe mësimnxënien  nga ana e studentëve në  përvetësimin e dijeve në nivel cilësor. Në përmbushjen e kesaj stradegjie KU "Luarasi" synon të zerë një vend të merituar brenda hapësirës Shqiptare të Arsimit të Lartë duke patur si udhërëfyese tendencat bashkëkohore të zhvillimeve në hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë.

Objektivat strategjike të KU "Luarasi" janë formuluar në zbatim të Vizionit e Misionit të tij dhe në përputhje me vlerat e tij. Ato iu përgjigjen çështjeve strategjike me të cilat përballet KU "Luarasi" .

Realizimi i objektivave stradegjike është konsideruar dhe konsiderohet si fokusi kryesor i punës së përditshme që karakterizon stafin akademik, organet drejtuese akademike organet drejtuese adminstrative dhe zyrat e shërbimeve ndaj studentëve. Filozofia jonë udhëheqëse në të gjitha veprimtaritë që realizohen në KU " Luarasi" ka qënë dhe mbetet "studenti në qëndër të vëmendjes".

***Objektivat stradegjike të formuluara në Planin e zhvillimit strategjik të KU " Luarasit" janë të zbërthyera dhe të pasqyruara edhe ne Planin vjetor 2017-2018. Objektivat e synuara në Planin afatshkurtër paraqiten si më poshtë vijon:***

- Programe dhe metoda të mësimdhënies bashkëkohore;
- Angazhim i stafit akademik cilësor, të qëndrueshëm,me grada shkencore dhe tituj akademik, si dhe me eksperiencë pune në fushën e gjyqësorit, të prokurorisë, të administratës, të avokatisë, të bankave, të financave, të manaxhimit, etj;
- Ndërtimit të urave të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- Krijimit të një mjedisi nxitës e zhvillues për studentët, pedagogët dhe punonjësit
- Ofrimi i shkollimit për një numër të arsyeshëm studentësh, konform kapaciteteve që institucioni disponon;
- Punë cilësore dhe të diferencuar me grupe studentësh apo individë të veçantë që trashëgojnë apo paraqesin dobësi dhe vështirësi në asimilimin e programeve mësimore;
- Sigurim të ambjenteve dhe logjistikës së përshtatshme për realizimin e çdo aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor.

Viti akademik 2017 – 2018 ka shënuar arritje në përmbushjen e objektivave në planin afatshkurtër. Bazuar në realizimin e objektivave stradegjike. Pas përfundimit të fazës së zgjerimit të aktivitetit me degë dhe programe të reja studimi në vitin 2012, vëmendja kryesore është përqëndruar në konsolidimin e këtyre programeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, për t'i bërë ato të krahasueshëm me programet më të mira të fushave përkatëse, në vend e më gjerë.

Këto arritje vlerësohen, si pjesë e një përpjekje të vazhdueshme, për arritjen e objektivave të përcaktuara në planin afatmesëm dhe afatgjatë që, konsistojnë në realizimin e ekselencës akademike, nëpërmjet:

- Rritjes së cilësisë dhe numrit të pranimit të studentëve.
- Përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe ambientit të mësimit.
- Orientimit të kërkimit shkencor në përputhje me perspektivën europiane dhe objektivat e mijëvjecarit.
- Rritjes së vazhdueshme të burimeve të financimit për institucionin.
- Përpjekje të vazhdueshme për zgjerimin e bashkëpunimit me institucione europiane të arsimit të lartë, duke synuar rritjen e shkëmbimeve në nivelin e personelit akademik, këmbimin e literaturës shkencore në funksion të studentëve, realizimin e mobilitetit të *studentëve, pjesmarrjen në projekte të përbashkëta të kërkimit shkencor, etj.,*

Gjithe veprimtaria mësimore shkencore dhe edukative në KU "Luarasi" është manaxhuar me efektivitet dhe përkushtim të lartë nga organet drejtuese akademike: Senati akademik, Asambleja e personelit, Komisionete perhershme si dhe organet kolegjiale: Rektorati dhe Dekanatet e Fakulteteve. Funksionet dhe detyrat e këtyre organeve janë të përcaktuara qartë në Statutin e KU "Luarasit" si dhe në Rregulloret apo procedurat që janë formuluar në zbatim të Statutit.

Garantimi i cilësisë dhe rritja e vazhdueshme e saj në nivelin e manxhimit akademik në KU "Luarasi" ka qënë dhe mbetet faktor determinues për të patur arritje dhe suksese në veprimtarinë mësimor, shencore dhe edukative. Fakti që KU "Luarasi" në procesin e akreditimin institucional nga ASCAL-i dhe Agjencia Britanike e cilësisë morri vlerësimin maksimal për një afat 6 vjeçar është dëshmia më e plotë që e forcon pohimin e mësipërm.

Njësia e Brëndëshme e Sigurimit të Cilësisë në kuadër të KU "Luarasit" udhëhoqi të gjithë procesin e akreditimit institucional. Hartoi Raportin e Vetevlerësimit të Brendshëm dhe njëkohësisht paraqiti dokumentacionin e kërkuar, voluminoz, me cilësi dhe në afatet e caktuar. Vlen të theksojmë se procesi ishte gjithëpërfshirës dhe kishte si qëlim edhe krijimin e kulturës së vletëvlerësimit nga të gjithë pjesmarrësit në të.

**Ekipi i Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë (dy anglezë dhe një shqiptar) në Raportin e tij përfundimtyar për të pesë fushat e mësipërme dha vlerësimin maksimal:** ***"full meet". Bazuar në këtë Raport Këshilli i akreditimit ka lëshuar Çertifikatë në të cilën theksohet:***
KU Luarasi do të riakreditohet institucionalisht pas 6 vitesh, periudhë maksimale e mundëshmë.

Natyrisht kjo është një arritje shumë e madhe dhe vlerësim i punës me përkushtim që bëhet në të gjitha veprimtaritë në KU "Luarasi" si nga Rektorati, Dekanatet e fakulteteve, stafi akademik dhe stafi administrativ. Kjo arritje na gëzon të gjithëve por, njëkohësisht na nxit dhe motivon për garantimin e cilësisë së arritur dhe përmirësimin e vazhdeshëm të saj. Cilësia nuk ka kufij të sipërm, ne synojmë të jemi ndër më të mirët.

## 1. Struktura organizative dhe titullarët

KU "Luarasi" është i organizuar konform Urdhërit Nr. 188, datë 15.05.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për riorganizimin e njësive kryesore të institucionit të arsimit të lartë "Shkolla e Lartë Private "Luarasi."

Struktura organizative mbështetet në përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe aktet normative të institucionit – Statut dhe Rregullore. Statuti dhe Rregullorja përcaktojnë, në mënyrë të detajuar, përbërjen, kompetencat e secilit organ/autoritet drejtues dhe mënyrën e funksionimit të Organeve dhe Autoriteteve Drejtuese të KU " Luarasi".

Struktura organizative e KU "Luarasi", për vitin akademik 2017 – 2018, paraqitet si vijon:

a) **Organeve drejtuese akademike**:
   1. Senati akademik;
   2. Asambleja e Personelit;
   3. Komisionet e përhershme

b) **Organeve të tjera kolegjiale:**
   a) Rektorati
   b) Dekanati

c) **Këshillit i etikës**.

d) **Organeve drejtuese administrative**:
   1. Bordi i administrimit
   2. Admnistratori i institucionit
   3. Administratori i njësisë kryesore

e) **Struktura arsimore akademike**

1. **Dy njësi kryesore**
   a) **Fakulteti i Drejtësisë**
   b) **Fakulteti Ekonomik**

2. **Çdo Fakultet ka tre njesi bazë:**
   A. **Fakulteti i drejtësisë**
      - Departamenti i së Drejtës Publike
      - Departamenti i së Drejtës Penale
      - Departamenti i së Drejtës Private
   B. **Fakulteti Ekonomik**
      - Departamenti Financë –Bankë
      - Departamenti Administrim Binesi
      - Departamenti i Ekonomiksit

Gjatë vitit akademik 2017-2018 nuk ka patur asnjë ndryshim në strukturën organizative të parashikuar në Statutin e KU "Luarasit" dhe në Urdhërin Nr.188, datë 15.05.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për riorganizimin e njësive kryesore të institucionit të arsimit të lartë "Shkolla e Lartë Private "Luarasi.""

## III. INFORMACION MBI TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT QË OFRON KU "LUARASI"

Kolegji Universiatar "Luarasi" ofron programe studimi në fushën e drejtësisë, që prej vitit 2003, dhe në atë të ekonomisë prej vitit 2012. Institucioni ka si objektiv kryesor përgatitjen e specialistëve, në ciklin e parë të studimeve, me profil në drejtësi, financë bankë, dhe administrim biznesi, me nivel bashkëkohor teorik dhe praktiko-aplikativ, për të përballuar kërkesat në rritje për profesionalizëm dhe cilësi në këto fusha studimi e veprimtarie. Institucioni, gjithashtu, ka për qëllim të përgatisë, në ciklin e dytë të studimeve, specialistë me formim të thelluar dhe të profilizuar, në fushat e shkencave juridike dhe ekonomike. Nga viti akademik 2018-2019, Kolegji Universiatar "Luarasi" do të ofrojë dhe programe studimi në fushën e Teknologjisë së Informacioni dhe Inovacionit.

| Nr. | Program i Studimit | Statusi aktual i programit | Licensim/Akreditim | Vlefshmëria e akreditimit |
|---|---|---|---|---|
| 1. | **"Bachelor" në "Drejtësi"** | Aktiv | **Akredituar** me Urdhër Nr. 271, datë 29.06.2012 | 29-06-2018 (Në process riakreditimi) |
| 2. | **"Bachelor" në "Financë Bankë"** | Aktiv | **Akredituar** me Urdhër Nr. 433, datë 25.08.2016 | 25-08-2022 |
| 3. | **"Bachelor" në "Administrim Biznesi"** | Aktiv | **Akredituar** me Urdhër Nr. 434, datë 2016-08-25 | 19-01-2022 |
| 4. | **"Bachelor" në "Informatikë Ekonomike"** | Aktiv | **Licensuar** me Urdhër Nr.417, datë 16.07.2018 | |
| 5. | **"Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni"** | Aktiv | **Licensuar** me Urdhër Nr. 398, datë 11.07.2018 | |
| 6. | **"Master i Shkencave" në "E drejtë Civile dhe Tregtare"** | Aktiv | **Akredituar** me Urdhër Nr. 323, datë 15.08.2013 | 15-08-2019 |
| 7. | **"Master i Shkencave" në "E drejtë Penale"** | Aktiv | **Akredituar** me Urdhër Nr. 323, datë 15.08.2013 | 15-08-2019 |
| 8. | **"Master i Shkencave" në "Menaxhim Ekzekutiv"** | Aktiv | **Akredituar** me Urdhër Nr. 432, datë 25.08.2016 | 19-01-2022 |
| 9. | **"Master i Shkencave" në "Bankat dhe Tregjet Financiare"** | Aktiv | **Akredituar** me Urdhër Nr. 431, datë 29.08.2016 | 19-01-2022 |
| 10. | **"Master i Shkencave" në "Teknologji informacioni dhe inovacionit"** | Aktiv | **Licensuar** me Urdhër Nr. 418, datë 16.07.2018 | |
| 11. | **"Master Profesional" në "Siguria kibernetike dhe e informacionit"** | Aktiv | **Licensuar** me Urdhër Nr. 419, datë 16.07.2018 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 12. | **"Master Profesional" në "Marketing dhe Reklamë"** | Aktiv | **Akredituar** me Urdhër Nr. 382, datë 08.07.2016<br>**Riorganizuar** me Vendim nga MASR Nr. 5912/1, Prot. datë 13.09.2018 | 08-07-2022 |
| 13. | **"Master Profesional" në "Financë dhe Menaxhim Risku"** | Aktiv | **Akredituar** me Urdhër Nr. 471, datë 19.09.2016<br>**Riorganizuar** me Vendim nga MASR Nr. 5912/1, Prot. datë 13.09.2018 | 19-09-2022 |
| 14. | **"Master Profesional" në "Kontabilitet"** | Ky program studimi është aktualisht në proces licensimi në MASR | | |
| 15. | **"Master Profesional" në "Menaxhim Sigurimesh"** | Aktiv | **Licensuar** me Urdhër Nr. 512, datë 16.10.2017 | **Në proces akreditimi** |
| 16. | **"Master Profesional" në "Siguria dhe rendi publik"** | Aktiv | **Licensuar** me Urdhër Nr. 511, datë 16.10.2017 | **Në proces akreditimi** |
| 17. | **"Master Profesional" në "E Drejtë Bankare dhe Financiare"** | Joaktiv | **Akredituar** me Urdhër Nr. 265, datë 20.05.2016 | 20-05-2022 |
| 18. | **"Master Profesional" në "Standardet Europiane për Policimin dhe Inteligjencën"** | Joaktiv | **Akredituar** me Urdhër Nr. 264, datë 20.05.2016 | 20-05-2022 |

### *1. Përshtatshmëria e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimi i synmeve të programeve dhe lidhjen e programeve me kerkesat e tregut të punës*

KU "Luarasi" ka krijuar, me përvojën 15 vjeçare, profilin e qartë të një institucioni elitar në mësimdhënie në fushën e drejtësisë. Zgjerimi në kuadër të implementimit të Planit të Zhvillimit Institucional 2016 – 2020, drejt ofrimit të programeve të studimit edhe në fushën ekonomike dhe informatike, ka konturuar, në mënyrë definitive, fushat prioritare të aktivitetit. Politikat e mësimdhënies dhe programet e ofruara nga KU "Luarasi", janë hartuar në përputhje të plotë me politikat kombëtare, të parashikuara në planin strategjik mbi arsimin e lartë. Këto programe studimi që ofrohen, në fushat e drejtësisë dhe ekonomisë, janë hartuar dhe realizohen në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e institucionit, që përmblidhet në angazhimin për krijimin e një institucioni elitar, i cili prodhon profesionistë të përgjegjshëm, me shpirt të orientuar drejt kërkimit dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Programet e studimit përkojnë tërësisht me misionin e Kolegjit Universitar "Luarasi" i cili synon të jete një qëndër ekselence në formimin akademik të studentëve nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale synon të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe të integrojë mësimdhëninen me kërkimin shkencor në mënyrë që të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social e kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal.

Objektivat e programeve identifikohen qartazi në përmbajtjen e syllabuse-ve, ndërtimin e procesit mësimor, mënyrën e vlerësimit të studentit, përzgjedhjen e literaturës, etj., elementë të cilët janë

konceptuar, në tërësinë e tyre, për të garantuar diplomimin e profesionistëve të aftë për të punuar në fushat e përzgjedhura apo për të realizuar studime të avancuara.
Në këtë kuadër, këto programe studimi për përcaktimin e objektivave të tyre janë bazuar pikërisht në misionin dhe vizionin e KU "Luarasi". Objektivat e programve të studimit synojnë janë hartuar në harmoni me kurrikulat e universiteteve më të mira perëndimore, si dhe janë në koherencë me dinamikën e zhvillimeve kombëtare dhe nevojat që shfaq tregu shqiptar i punës. Të gjitha programet e studimit të të gjitha niveleve të ofruara nga KU "Luarasi" janë miratuar pas një studimi të hollësishëm të nevojave të tregut, të mundësive dhe kapaciteteve që përballon ky institucion, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, si dhe pas një procedurë rigoroze diskutimi dhe miratimi në njësitë dhe organet drejtuese të KU "Luarasi".

## *2. Realizimi i synimeve të programeve të studimit nga ana përmbajtësore*

Programet e studimit që ofrohen nga Kolegji Universitar "Luarasi", në të dy ciklet e studimit, synojnë përgatitjen e individëve të kualifikuar për karrierë në sektorin privat dhe publik, duke siguruar një arsimim të gjerë profesional dhe shkencor. Bazuar në Kartën e Bolonjës, që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit Bachelor, programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" pajisin studentët me njohuritë bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Ndërkohë, programet e ciklit të dytë të studimeve, pajisin studentët me njohuri të thelluara në fushat përkatëse, si bazë për karrierë të sukseshme profesionale apo për avancimin në karrierë akademike. Programet synojnë harmonizimin e njohurive, duke filluar me ato bazë teorike, të fushës përkatëse dhe ndihmëse, dhe vijojnë me njohuri të thelluara në fushat specifike. Programet u ofrojnë studentëve lëndë të formimit të përgjithshëm dhe karakterizues të integruar me praktika mësimore që studenti të përshtatet plotësisht me tregun e punës.

Gjatë vitit akademik 2017-2018 KU "Luarasi", për tju përshtatur kërkesave të tregut të punës, ka hapur dy Mastera Profesional, përkatësisht, në Fakultetin Ekonomik Master Profesional "Menaxhim Sigurimesh" dhe në Fakultetin e Drejtësisë Master Profesional "Siguria dhe Rendi Publik". Në këtë kuadër dhe në përputhje me planin strategjik, u hap këtë vit akademik Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. Ky fakultet do të ofrojë në vitin akademik 2018-2019 4 programe të reja studimi. Në ciklin e studimit "Bachelor" do të ofrojë "Informatikë Ekonomike" dhe "Teknologji Informacioni dhe Inovacion" dhe në ciklin e studimit "Master" do të ofrojë Master Profesional në "Siguria kibernetike dhe e informacionit" dhe Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" . Këto programe janë hartuar duke u bazuar në kërkesat reale të tregut të punës për specialistë të ketyra fushave specifike.

Brenda kësaj kornize vlen të theksohet edhe fakti i rishikimit periodik të studimit të tregut të punës, harmonizuar kjo me përqasjen akademike në trendin aktual. Në lidhje me këtë, institucioni ka punuar gjatë vitit akademik 2017-2018 për riorganizimin e dy programeve studimore master profesional dhe hapjen e një masteri professional të ri në Fakultetin Ekonomik.

Me qëllim mundësimin e integrimit sa më të lehtë të të diplomuarve në tregun e punës, një rëndësi e veçantë i është kushtuar lëndëve praktike, si dhe praktikave mësimore e profesionale, qoftë si pjesë e aktiviteteve kurrikulare, ashtu edhe atyre jashtëkurrikulare. Vlen të përmendet këtu Klinika

Ligjore në Fakultetin e Drejtësisë, organizimi i praktikave mësimore në institucione publike dhe kompani me të cilat KU "Luarasi" ka marrëveshje bashkëpunimi.

### 3. *Realizimi i synimeve të programit të studimit nëpërmjet mbulimit me personelin akademik të përshtatshëm*

KU "Luarasi", për vitin akademik 2016 - 2017, ka siguruar personelin akademik të nevojshëm dhe të mirëkualifikuar për të garantuar realizimin me sukses të programeve të studimit. Institucioni ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore, sa i takon numrit dhe angazhimit të personelit akademik efektiv, duke e harmonizuar në procesin e mësimdhënies me personelin akademik me kontratë, për të garantuar cilësi maksimale lektorësh në lëndë specifike dhe të rëndësishme.

Struktura e personelit akademik, në mënyrë të përmbledhur, për vitin akademik 2016 -2017, në momentin aktual (gjatë vitit kanë ndodhur ndryshime për shkak të largimit apo rekrutimit të pedagogëve), paraqitet si vijon:

### 4. *Informacion mbi marrjen e lejës për hapjen e programeve të studimit që janë në process vlerësimi*

Kolegji Universitar "Luarasi" me qëllim fillimin e plotësimit të nevojave profesionale të tregut, bazuar në nenin 35, paragrafi 2 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenet 13 dhe 14 të Statutit të KU "Luarasi", në propozimin e njësive bazë dhe të Fakulteteve të Drejtësisë dhe Ekonomikut për hapjen e programeve të studimit Master Profesional në "Siguria dhe Rendi Publik" dhe në "Menaxhim Sigurimesh", Senati Akademik i KU "Luarasi" miratoi hapjen e programit të studimeve të ciklit të dytë "**Master Profesional" në "Siguria dhe Rendi Publik" dhe në "Menaxhim i Sigurimeve" për vitin akademik 2017-2018.** Këto programe u licensuan nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe u testuan të suksesshëm me brezin e parë të studentëve në vitin akademik 2017-2018. Aktualisht, këto programe studimi janë në proces akreditimi.

Programi i studimeve "Master Profesional" në "Siguria dhe Rendi Publik" ka objektiva të qartë formues e profesionalë, ndër to veçojmë:

- ✓ zhvillimin tek studentët të njohurive e aftësive të gjera e të thelluara profesionale për vlerësim kritik dhe mendim analitik të pavarur, aftësi për të zgjidhur probleme komplekse dhe për t'u rritur në karrierën profesionale;
- ✓ mbështetjen dhe promovimin në karrierë të studentëve që do të ndjekin këtë program studimi;
- ✓ përmirësimin e niveleve të drejtimit e menaxhimit dhe rritjen e kapaciteteve organizative, administrative e operacionale të strukturave dhe shërbimeve të sigurisë, si dhe realizimin e kompletimin me infrastrukturën e nevojshme ligjore, nënligjore e normative;
- ✓ rritjen e aftësive menaxhuese e drejtuese për shërbimet ekzekutive ndaj kontrollit të territorit si Policisë së Shtetit, shërbimeve të emergjencës, policive bashkiake, sistemit penitenciar, hetimit tatimor e doganor etj. si dhe gjallërimin e mekanizmave monitorues të punës dhe performancës në sektorët e sigurisë.

- ✓ plotësimin e nevojave që kanë strukturat e sektorit të sigurisë për resurse të afta profesionalisht dhe specialistë me nivel të lartë kulturor, nivel që përputhet me zhvillimin social e ekonomik të vendit, të cilët do të mbështesin zhvillimin më tej të interesave dhe vlerave kombëtare. Realizimin e studimeve bashkëkohore, të cilat krahas vlerësimit të përvojave, marrin në konsideratë kërkesat në rritje të shoqërisë për një profesionalizëm në rritje të sektorit të sigurisë.

Programi i studimeve "Master Profesional" në "Menaxhim i Sigurimeve" ka objektiva të qartë formues e profesionalë, ndër to veçojmë:

- ✓ zhvillimin tek studentët të njohurive e aftësive të gjera e të thelluara profesionale për vlerësim kritik dhe mendim analitik të pavarur, aftësi për të zgjidhur probleme komplekse dhe për t'u rritur në karrierën profesionale në fushën e sigurimeve;
- ✓ mbështetjen dhe promovimin në karrierë të studentëve që do të ndjekin këtë program studimi;
- ✓ përmirësimin e niveleve të drejtimit e menaxhimit dhe rritjen e kapaciteteve organizative, administrative e operacionale të strukturave dhe shërbimeve të sigurimeve ;
- ✓ rritjen e aftësive menaxhuese e drejtuese për shërbimet ekzekutive ndaj qytetarëve, shërbimeve të emergjencës, të sigurimit të jetës dhe të jo - jetës si dhe në gjallërimin e mekanizmave monitorues të punës dhe performancës në sektorët e sigurimeve.

Plotësimin e nevojave që kanë strukturat e sektorit të sigurimeve për resurse të afta profesionalisht dhe specialistë me nivel të lartë kulturor, nivel që përputhet me kërkesat e zhvillimin social e ekonomik të vendit. Realizimin e studimeve bashkëkohore, të cilat krahas vlerësimit të përvojave, marrin në konsideratë kërkesat në rritje të tregut të sigurimeve brenda dhe jashtë vendit.

## IV. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME NUMERIKE TË INSTITUCIONIT

### 1. Të dhënat statistikore mbi studentët

***(1) Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar dhe të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit:***

Për vitin akademik 2017 - 2018, numri i studentëve të regjistruar pranë Fakultetit të Drejtësisë është **382** studentë, të ndarë sipas programeve të studimit si më poshtë vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **"Bachelor" në "Drejtësi"** | **Viti i parë** | **97** |
| | Viti i dytë | 77 |
| | Viti i tretë | 66 |
| | **Total** | **240** |
| **"Master i Shkencave" në "E Drejtë Civile dhe Tregtare"** | Viti i parë | 48 |
| | Viti i dyte | 26 |
| | **Total** | **74** |
| **"Master i Shkencave" në "E Drejtë Penale"** | Viti i parë | 38 |
| | Viti i dytë | 15 |

| | | |
|---|---|---|
| | **Total** | **53** |
| **Master Profesional në "Siguria dhe Rendi Publik"** | Viti i parë | 15 |
| | **Total** | **15** |
| Total Fakulteti i Drejtësisë | **382 studentë** | |

Për vitin akademik 2017 - 2018, numri i studentëve të regjistruar pranë Fakultetit Ekonomik është **337** studentë, të ndarë sipas programeve të studimit si më poshtë vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **"Bachelor" në "Administrim Biznes"** | **Viti i Parë** | **37** |
| | Viti i Dytë | 22 |
| | Viti i Tretë | 51 |
| | **Total** | **110** |
| **"Bachelor" në "Financë Bankë"** | Viti i Parë | 30 |
| | Viti i Dytë | 33 |
| | Viti i Tretë | 21 |
| | **Total** | **85** |
| **"Master i Shkencave" në "Menaxhim Ekzekutiv"** | Viti i Parë | 47 |
| | Viti i Dytë | 14 |
| | **Total** | **61** |
| **"Master i Shkencave" në "Bankat dhe Tregjet Financiare"** | Viti i Parë | 21 |
| | Viti i Dytë | 8 |
| | **Total** | **29** |
| **"Master Profesional" në "Menaxhim Sigurimesh"** | Viti i Parë | 52 |
| | **Total** | **52** |
| **Total Fakulteti Ekonomik** | **337 studentë** | |

***<u>Numri i studentëve të diplomuar pranë Fakultetit të Drejtësisë</u>***

Për vitin akademik 2017 - 2018, numri i studentëve të diplomuar pranë Fakultetit të Drejtësisë është **81** studentë, të ndarë sipas programeve të studimit si më poshtë vijon:

| | |
|---|---|
| **"Bachelor" në "Drejtësi"** | **57** |
| **"Master i Shkencave" në "E Drejtë Civile dhe Tregtare"** | **24** |
| **"Master i Shkencave" në "E Drejtë Penale"** | **15** |
| **"Master Profesional" në "Siguria dhe Rendi Publik"** | **9** |
| **Total Fakulteti i Drejtësisë** | **105 studentë** |

***<u>Numri i studentëve të diplomuar pranë Fakultetit Ekonomik</u>***

Për vitin akademik 2017 - 2018, numri i studentëve të diplomuar pranë Fakultetit Ekonomik është **88** studentë, të ndarë sipas programeve të studimit si më poshtë vijon:

| | |
|---|---|
| **“Bachelor” në "Administrim Biznes"** | **35** |
| **“Bachelor” në "Financë Bankë"** | **18** |
| **“Master i Shkencave” në “Menaxhim Ekzekutiv”** | **14** |
| **“Master i Shkencave” në “Bankat dhe Tregjet Financiare”** | **5** |
| **“Master Profesional” në “Menaxhim Sigurimesh”** | **16** |
| **Total Fakulteti Ekonomik** | **88 studentë** |

***(2) Numri i studentëve të shkëlqyer***

Për vitin akademik 2017 - 2018, numri i studentëve të shkëlqyer pranë Fakultetit të Drejtësisë është **8** studentë, të ndarë sipas programeve të studimit si më poshtë vijon:

| | |
|---|---|
| **“Bachelor” në “Drejtësi”** | **6** |
| **“Master i Shkencave” në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”** | **2** |
| **Total Fakulteti i Drejtësisë** | **8 studentë** |

Për vitin akademik 2017 - 2018, numri i studentëve të shkëlqyer pranë Fakultetit Ekonomik është **5** studentë, të ndarë sipas programeve të studimit si më poshtë vijon:

| | |
|---|---|
| **“Bachelor” në "Administrim Biznes"** | **1** |
| **“Bachelor” në "Financë Bankë"** | **4** |
| **“Master i Shkencave” në “Menaxhim Ekzekutiv”** | **0** |
| **“Master i Shkencave” në “Bankat dhe Tregjet Financiare”** | **0** |
| **“Master Profesional” në “Menaxhim Sigurimesh”** | **0** |
| **Total Fakulteti Ekonomik** | **5 studentë** |

**(3) Numri i studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen**

***- Numri i Studentëve të transferuar pranë Fakultetit të Drejtësisë***

Për vitin akademik 2017 - 2018, numri i studentëve të transferuar pranë Fakultetit të Drejtësisë është **16** studentë, të ndarë sipas programeve të studimit si më poshtë vijon:

| Program i Studimit | Numri i studentëve | IAL nga tranferohen |
|---|---|---|
| **“Bachelor” në “Drejtësi”** | **16** | **Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës = 9 student** |
| | | **Kolegji Universitar “Wisdom” = 1 student** |
| | | **Tirana Bussins University = 1 student** |
| | | **Universiteti “Luigj Gurakuqi” = 1 student** |

| | | |
|---|---|---|
| | | **Akademia Profesionale e Biznesit = 1 student** |
| | | **Albania University-Berat = 1 student** |
| | | **Universiteti i Genoves = 1 student** |
| | | **Universiteti Europian i Tiranes = 1 student** |
| **"Master i Shkencave" në "E Drejtë Civile dhe Tregtare"** | **0** | **0** |
| **"Master i Shkencave" në "E Drejtë Penale"** | **0** | **0** |
| **Master Profesional në "Siguria dhe Rendi Publik"** | **0** | **0** |
| **Total Fakulteti i Drejtësisë** | | **16 studentë** |

***- Numri i Studentëve të transferuar pranë Fakultetit Ekonomik***

Për vitin akademik 2017 - 2018, numri i studentëve të transferuar pranë Fakultetit Ekonomik është **37** studentë, të ndarë sipas programeve të studimit si më poshtë vijon:

| Program i Studimit | Numri i studentëve | IAL nga tranferohen |
|---|---|---|
| **Bachelor në "Administrim Biznes"** | **23** | **Fakulteti i Ekonomisë, UT=4 studentë** |
| | | **Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës=15 studentë** |
| | | **Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë=1 student** |
| | | **Universiteti i Ekonomisë Kombëtare, Sofje=1 student** |
| | | **Universiteti "Marlin Barleti"=1 student** |
| | | **Fakulteti i Gjeologji Minierave=1 student** |
| **Bachelor në "Financë Bankë"** | **13** | **Fakulteti i Ekonomisë, UT=3 studentë** |
| | | **Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës=2 studentë** |
| | | **Universiteti Europian i Tiranës=1 student** |
| | | **Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan=1 student** |
| | | **Fakulteti i Shkencave të Natyrës, UT=1 student** |
| | | **5 studentë janë transferuar brenda KU "Luarasi", nga Administrim Biznesi në Financë Bankë** |
| **Master i Shkencave në "Menaxhim Ekzekutiv"** | **1** | **Universiteti Europian i Tiranës=1 student** |

| | | |
|---|---|---|
| **Master i Shkencave në "Bankat dhe Tregjet Financiare"** | **0** | **0** |
| **Master Profesional në "Menaxhim Sigurimesh"** | **0** | **0** |
| **Total Fakulteti Ekonomik** | | **37 studentë** |

***Numri i Studentëve të c'regjistruar nga Fakulteti i Drejtësisë***

Për vitin akademik 2017 - 2018, numri i studentëve të ç'regjistruar pranë Fakultetit të Drejtësisë është **2** studentë, të ndarë sipas programeve të studimit si më poshtë vijon:

| Program i Studimit | Numri i studentëve të c'regjistruar |
|---|---|
| **"Bachelor" në "Drejtësi"** | **2** |
| **"Master i Shkencave" në "E Drejtë Civile dhe Tregtare"** | **0** |
| **"Master i Shkencave" në "E Drejtë Penale"** | **0** |
| **Master Profesional në "Siguria dhe Rendi Publik"** | **0** |
| **Total Fakulteti i Drejtësisë** | **2 studentë** |

***Numri i Studentëve të c'regjistruar nga Fakulteti Ekonomik***

